Republika e Kosovës
Republika Kosova –Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 80/17
Datë/Datum. 05.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	80/17
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Komuna e Pejës - Parashtruesit të ankesës **"ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit Bullatovci
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar **"ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë, me numër protokollit 06/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/221, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Pejës.

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	05.04.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **"ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë, me numër protokollit 80/17.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bullatari		27.03.2017		28.03.2017		05.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 20 mars 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **"ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës.
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: "ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K." me seli në Pejë

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
- Shkelej e nenit 24 të LPP-së, Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Shkelje e nenit 69 të LPP-së, Aftësitë teknike dhe/ose profesionale;
- Shkelje e nenit 131 të LPP-së, Shkelja e Ligjit nga autoriteti kontraktues;
- Shkelje e nenit 7.3 dhe 7.4, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik-A01;
- Shkelje e nenit 41, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Rregullat dhe UOPP-A01;
- Shkelje e nenit 24 paragrafi 1 pika C, Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, "Grupi i operatoreve ekonomik".

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

AK, në kundërshtim me Vendimit Nr. 06/17, dt. 06.03.201 7 te OSHP-se dhe dispozitave te LPP-se, ne mënyrë diskriminuese ka bërë Ri-Vlerësimin duke u arsyetuar në konstatimet e Panelit shqyrtues:

Paneli shqyrtues, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës fakteve dhe provave të prezantuara, thënieve në seancën për shqyrtim kryesor, ka konstatua se lidhur ne pretendimin e OE ankues se gjate qasjes në dokumente zyrtare kanë hasur në parregullsi pasi që (OE-së të rekomanduar për lot I. i ka munguar "Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-se, krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik 11.1 pika C. që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes tenderit, po ashtu në kundërshtim me i UO 24. pika C. lidhur me këtë paneli shqyrtues sqaron se konzorciumi i rekomanduar për kontratë "Doreärti & Graniti & Lindi Markings"- Pejë, në këtë aktivitet të prokurimit si dëshmi ka ofruar vetëm marrëveshjen e Konzorciumit, duke premtuar se do të veprojnë

si ndërmarrje e përbashkët në kryerjen e punëve që ka qenë e nënshkruan dhe vulosur tre anëtarët e grupit së bashku me Deklaratat. Bazuar në dokumentet e lart përmendura shihet se mungon deklarata e anëtarëve të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës që veproj emër të grupit e që është në kundërshtim me kërkesat në nenin 27. pika c tek. Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim A01 .

- Paneli shqyrtues, po ashtu ka konstatuar se lidhur me pretendimin : OE ankues ku thuhet se OE rekomanduar për kontratë nuk i përmbush dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të dosjes së tenderit për kërkesën 1. Listën e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE origjinal, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data te kontraktimit edhe vlera, gjithashtu të bashkangjitur të jenë referenca ose procesverbalet e pranimit në të cilën janë të përfshirë edhe titujt e projekteve për Lot 1, bazuar në shkresat e lëndës OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi ka ofruar listën e punëve të kryera të bashkangjitur me kontrata dhe referenca të vulosura në kopje e jo origjinal, përkitazi ne kërkesën e nenit 9.2 të FID -së. Andaj paneli shqyrtues konstaton se AK KK Pejë nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat LPP-së, pasi që ka qenë dashur që konform nenit 72 të LPP-së të kërkojë Sqarime shtesë.

Vendimi i OSHP-së Nr. 06/17- Paneli Shqyrtues qartë KONSTATON se:

1. OE i rekomanduar për Lot 1, i ka munguar "Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së, krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik. 11.1 pika C, që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit e po ashtu në kundërshtim me UO 24.1 pika C..... Bazuar në dokumentet e lartpërmendura shihet se mungon deklarata e anëtarëve të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqësin që të veproi në emër të grupit, e që është në kundërshtim me kërkesat në nenin 27.1 pika C tek Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim-AO1.

2. Paneli Shqyrtues, po ashtu ka KONSTATATUAR se OE I rekomanduar për kontratë nuk i përmbush dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të dosjes së tenderit për kërkesën 1. Lista e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE-origjinal, ku përfshihen titujt e projekteve, numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur te jen referencat ose procesverbalet te pranimit. Për LOTO - 1,2,3, bazuar në shkresën e lëndës OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi ka ofruar listën e punëve të kryera të bashkangjitura me kontrata dhe referenca të vulosura në KOPJE e JO ORIGJINAL përkitazi me kërkesën e nenit 92 të FDT-së. Andaj paneli Shqyrtues konstaton se KK Peje nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, pasi që ka QEN DASHUR që konform nenit 72 të LPP-së të

AK Komuna e Pejës përpiqet të sqaroj se në bazë të Vendimit të OSHP-së kanë vepruar konform nenit 72 të LPP-së duke kërkuar dokumente shtese nga OE i cili sipas vendimit 06/17 ishte i pa përgjegjshëm.

Pasi që, nuk na është LEJUAR QASJA në Dokumente Zyrtare nga Autoriteti Kontraktues , nuk e kemi pas te mundur të njoftohemi se si është vepruar nga AK. Por vetë fakti I mos lejimit në Qasie vërteton dyshimin e respektimit te LPP-së

Nuk na mbetet asgjë tjetër veç të kërkojmë nga OSHP të Vërtetoi Vendimin 06/17 dhe të merr masa Ligjore ndaj AK për mos zbatimin e Vendimit 06/17, e po ashtu edhe për veprimet e marra në Kundërshtim me Legjislacionin në FUQI sa u përket.

1. Nenin 10 I LPP-së Mjetet për Promovimi i transparencës, 2. Nenin 7.3 dhe 7.4 te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për

prokurim-AO1

Duke mos na lejuar qasje në dokumente zyrtare, pas "RI-Vlerësimit" (Dëshmia 1)

2. Nenin 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tender-AO1

3. Neni 41.3 Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit -AO1 5.

4. Nenet 39., 39.1, 39.2, 39.3 Sqarimi i Tenderëve -AO1

5. Neni 72.3 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 39.3 sqaron se.... lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyrë objektive duhet të prezantojnë se kane ekzistuar para afatit te fundit të dorëzimit te aplikacionit apo te dorëzimit të tenderit. Përveç kësaj, kërkesa nuk do te duhej qe të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës.

Është e ditur se:

OE e propozuar për Kontratë ka dështuar të përmbushë Kërkesat e Dosjes së Tenderit (me sqarimet-informatat e AK te datës 13 dhe 14.12.2016) lidhur me këtë Aktivitet të Prokurimit, dhe atë:

1- Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së

Krijimi i një grupi te operatorëve ekonomik 11. 1 pika C. Ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit e po ashtu ne kundërshtim me UO 24. I, C

2- Lista e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE-origjinal, ku përfshihen titujt projekteve, numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur te jen referencat ose procesverbalet te pranimit. Për LOTO-1

Në LISTEN e SHERBIMEVE –JO ORIGJINAL - e dorëzuar vetëm nga njëri anëtar i konzorciumit " Dorarti" nuk ka të specifikuar as një kontratë të ngjashme - të mirëmbajtjes Dimërore. (Dëshmia 2)

3.- Lista e pajisjeve - mjeteve te punës qe OE duhet ti ketë në dispozicion (në pronësi te vetën) të dëshmohen me kopje te librezave, deklarate doganore apo ndonjë dëshmi tjetër, të specifikuar për LOTO'n për të cilën paraqet kërkesë.

OE për Lot I është dashtë të posedoi dhe të dëshmoi Makinerinë :

MAKINERIT LOT-1

1. *Kamion borëpastrues 3 copë*
2. *Makineri të lehtë për pastrimin e trotuareve dhe shesheve I copë*
3. *Makineri të lehtë (Skip) për ngarkimin e borës në kamion l copë*
4. *Makineri të rëndë (Ult) dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirëmbajtje dimëro*

<u>OE dështon të dëshmoi 3 kamion borëpastrues në pronësi e po ashtu dështon të dëshmoi Makinerinë e lehtë për pastrimin e trotuareve dhe Shesheve 1 copë.</u>

SQARIM:

- Kamion borëpastrues - janë kamionët të cilët janë të pajisur ne thikë(pllug) për pastrimin e bores dhe hedhësen e kripës.

- Makin e lehtë për pastrimin e trotuareve dhe shesheve është - makineri speciale e pajisur me thikë (pllug) për pastrim dhe hedhësen e rërës + kripës.)

Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni Vlerësues kanë bërë shkelje te një-pas njëshme duke mos përfill:

- Vendimin e OSHP-së dhe Legjislacionit në fuqi
- Kërkesat e Dosjes së tenderit dhe informatat shtesë (sqarimet)
- OE e propozuara për Kontratë dështojnë të paraqesin dokumentet e kërkuara nga AK si dhe në kundërshtim me LPP-në.
- AK dhe Komisionet Vlerësuese,mendoj që ka bërë shkelje morale dhe penale, (duke nënshkruar Deklaratën nën Betim) lidhur me nënshkrimin e vlerësimit të rrejshëm ose të gabuar në kundërshtim me Kërkesat e DT dhe të FDT-së.

PROPOZIMI

OSHP-së i propozojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga OE "ER-LIS &VE-MOR" Pejë lidhur me aktivitetin e prokurimit: Nr.PE 635-16-113-2-2-1, për tenderit: "MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNENPEJES" Lot1, të nxjerr:

V E N D I M I

APROVOJË: si të bazuar ankesën e OE "ER-LIS shpk& VE-MOR-shpk"

ANULOJ: Vendimin - Njoftimi për DHENIE TE KONTRATES

URDHËROHET: AK, Komuna e Pejës këtë A e P ta kthej ne RI-Vlerësim sipas LPP-së.

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1)	07.11.2016
Data e njoftimit për kontratë (N. 40)	05.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-	Procedura e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16):	Shërbime /e mesme
Vlera e përllogaritur për këtë prokurim (N.15-19):	Lot 1- 90,000.00 € 36muaj

Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9): .....

Afati kohor për pranimin e projekteve (gjithsejtë ditë): 15.12.2016

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60): .....Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët.

Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N.65-69):

1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

Dëshmitë dokumentare:

2. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi(duhet dorëzuar së bashku me tenderin).

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet .

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.

b. Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

Kërkesat përshtatshmërisë profesional (N. 66):

- Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
- Regjistrimi i TVSH;
- Regjistrimi i Numrit Fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
- Certifikata e TVSH- kopje
- Certifikata e numrit fiskal- kopje

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetori OE gjate tri viteve (2013, 2014,2015) për LOTO 1, ka me qene jo me pak se 180,000.00 €.
- Sigurimi i tenderit ne vlerë 4,000.00€
- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon transaksionet financiare për tri vitet e fundit 2013, 2014 dhe 2015, për LOTO -1.

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

- Shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit 2013,2014 dhe 2015 për LOTO 1, ka me qene jo me pak se 140,000.00 €.
- Lista e Mjeteve të punës për (LOT 1)- (LOT-2)-(LOT-3

Dëshmitë e kërkuara dokumentare

- Lista e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE-origjinal,ku përfshihen titujt e projekteve, numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur te jen referencat ose procesverbalet te pranimit. Për LOTO -1, LOTO -2 ,LOTO- 3.
- Lista e pajisjeve – mjeteve te punës qe OE duhet ti ketë në dispozicion(në pronësi te vetën)të dëshmohen me kopje te librezave, deklarate doganore apo ndonjë dëshmi tjetër, të specifikuar për LOTO' për të cilën paraqet kërkesë.

Nr.	MAKINERITLOT-1	SASIA
1	Kamion borëpastrues	3
2	Makineri të lehtë për pastrimin e trotuareve dhe shesheve	1
3	Makineri të lehtë (Skip) për ngarkimin e borës në kamion	1
4	Makineri të rëndë (Ultë)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirëmbajtjen dimërore	1

Nr.	MAKINERITLOT-2	SASIA
1	Kamion borëpastrues	3

2	Makineri të lehtë (Skip) për ngarkimin e borës në kamion	1
3	Makineri të rëndë (Ultë)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirëmbajtjen dimërore	1

Nr.	MAKINERITLOT-3	SASIA
1	Kamion borëpastrues	3
2	Makineri të rëndë (Ultë)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirëmbajtjen dimërore	1
Vrejtje1: Preferohet që O.E gjatë gjithë kohës së mirëmbajtjes dimërore makineritë ta ketë në Rugovë për shkak të reshjeve të mëdha dhe të shpeshta dhe se orët e punës do të llogariten vetëm orët efektiv dhe nuk do të llogariten orët nga vendndodhja e operatorit deri tek rrugët që do të mirëmbahen.		

Vërejtje 2: A.K për shkak të efikasitetit të punëve O.E do ti shpërblejë vetëm me një LLOT

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi Lot 1
1.	"ER-LIS&VE-MOR"	Pejë	79,212.00€
2.	"KE-LUANI"	Pejë	34,776.00€
3.	"HORN-CO&ENGINEERING GROUP"	Deçan	78,246.00€
4.	"DOREARTI&GRANITI&LINDI MARKINGS"	Pejë	24,150.00€
5.	"LIKA TRADE"	Deçan	28,980.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 4 (katër) OE, ku është lexuar shifra e operatorit ekonomik.

Komisionet vlerësues pran AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N. 59).

Autoriteti kontraktues, me dt. 27 shkurt 2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Gëzim Lajqi, Kryetar i komisionit
- Milot Belegu, Anëtar
- Sami Gashi, Anëtar

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimi:	01.03.2017
Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N. 41):	02.03.2017
Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):	09.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se 5 (pesë) operator ekonomik që kanë ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/22, 4 (katër) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 1 (një) operator ekonomik është i pa përgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- OE "HORN-CO&ENGINEERING GROUP" Deçan, i mungon shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit 2013,2014 dhe 2015 për Lot 1, ka qenë jo më pak se 140,000.00€. Lista e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE origjinal, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlera të bashkangjitura të jenë referencat ose procesverbalet të pranimit për Lot 1.

Duke u bazuar ne ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe duke pas për bazë kriterin për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, komision i vlerësimit rekomandon që OE "DOREARTI&GRANITI&MARKINGS" nga Peja, të shpallet fitues në aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/221, oferta e këtij operatori ekonomik është 72,450.00€.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/221, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muaj, shërbime, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Bazuar në dokumentacionin që ka në shqyrtim, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes parashtresë-Kërkesë për sqarime shtesë, te dt. 28 shkurt 2017, ka kërkuara nga OE "DOREARTI&GRANITI&MARKINGS", sqarim ku ndër të tjera thuhet: *Komisioni vlerësues ka shikuar tërë dokumentacionin e ofertuesve të cilët kanë ofertuar për Lot 1, dhe kanë ardhur në përfundim se grupi i OE "DOREARTI&GRANITI&MARKINGS"-konzerciumi është operator ekonomik i përgjegjshëm, por paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin Nr. 06/2017, të dt. 16.02.2017, i ka dhënë vërejtje autoritetit kontraktues se nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, pasi që nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së.*

Komisioni vlerësues në përbërje të plotë ka bërë evalumin e kësaj dosje dhe ka erdh ne përfundim që të respektohet vendimi i OSHP-së, dhe autoriteti kontraktues të kërkoj nga operatori ekonomik me çmimin më të lirë sqarime shtesë lidhur me këto çështje:

- *Caktimi i liderit në deklaratën e bashkëpunimit të këtij grupi të operatorëve (konzerciumi).*
- *Të precizohet lista e shërbimeve të kryera (origjinal) e mbështetur me referenca ose procesverbale.*
- *Të përcaktohet lista e pajisjeve për realizimin e punëve në këtë lot.*

Kërkojmë nga ju që në afat sa më të shkurtër ta njoftoj AK-së, lidhur me këto sqarime dhe nëse dështoni në sigurimin e këtyre të dhënave që brenda kësaj jave (03.03.2017), autoriteti kontraktues do te vazhdoj me operatorin ekonomik radhës të përgjegjshëm me çmimin ma te lirë.

Sqarimi: Nr. 3

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së, ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se operatori ekonomik ankues me dt. 06 mars 2017, për mes shkresës elektronike (e-mailt), ka bërë kërkesë në autoritet kontraktues për qasje ne dokumente të ofertuesve dhe raportit të komisionit në bazë të Ligjit.

Ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron, se nuk ka hasur në ndonjë shkresë se autoriteti kontraktues nuk i ka lejuar qasje ne dokumentacion të tenderit operatorit ekonomik ankues ashtu si parashihet ne nenin 10 paragrafi 3 të LPP-së, ku thuhet: *autoritetit kontraktues është i obliguar që pas kërkesës me shkrim nga cilado palë e interesit, ti i siguron qasje të arsyeshme palës-operatorit ekonomik ankues që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur.* Ndërsa, në paragrafin 5 të nenit 10 thuhet: "*Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni*".

Sqarimi: Nr. 4

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 24 paragrafi 1 pika C të UOPP, respektivisht se : *OE e propozuar për Kontratë ka dështuar të përmbushë Kërkesat e Dosjes së Tenderit (me sqarimet-informatat e AK te datës 13 dhe 14.12.2016) lidhur me këtë Aktivitet të Prokurimit, dhe atë: Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së. Krijimi i një grupi te operatorëve ekonomik 11.1 pika C. Ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit e po ashtu ne kundërshtim me UO 24. 1, C*", ekspertja shqyrtuese sqaron se autoriteti kontraktues konform nenit 72

të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë me dt. 28 shkurt 2017, ndërsa po të njëjtën datë operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë dorëzon në autoriteti kontraktues vendimin për caktimin e liderit, ku ndër të tjera thuhet: *Ne si koncersium i përbashkët e caktojmë kompaninë N.P. "Dorearti" si lider i konzerciumit në projektin:* ***"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" (Lot 1/Lot 2/Lot 3), respektivisht "Mirëmbajtja e rrugëve në qytet-Lot 1"*** *me nr. të prokurimit 635/16/113/221, të shpallur nga Komuna e Pejës.*

Sqarimi: Nr. 5

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: *"Në LISTEN e SHERBIMEVE –JO ORIGJINAL - e dorëzuar vetëm nga njëri anëtar i konzorciumit "Dorarti" nuk ka të specifikuar as një kontratë të ngjashme - të mirëmbajtjes Dimërore. (Dëshmia 2,* ekspertja shqyrtuese bazuar ne shkresat lëndës sqaron se autoriteti kontraktues konform nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, me dt. 28 shkurt 2017, ku thuhet: *Të precizohet lista e shërbimeve të kryera (origjinal) e mbështetur me referenca ose procesverbale.*

Konzorciumi i OE i rekomanduar për kontratë konform kërkesës së autoriteti kontraktues ka me dt. 28 shkurt 2017, dorëzon në autoriteti kontraktues: Listën e projekteve të kryera gjatë vitit 2013-2014-2015, nga OE N.P. "DOREARTI"& N.T. "LINDI MARKINGS" (origjinal). Listën e projektevepunimeve nga lëmin e infrastrukturës rrugore të kryer gjatë vitit 2013, 2014 dhe 2015 nga OE "GRANIT" sh.p.k. Istog (origjinal), të bashkangjitur kontratën me Ministrinë e Infrastrukturës dhe referencën me Nr. të prokurimit MI/13/041/2013, ne vlerë prej 958,478.54€.

Ekspertja shqyrtues bazuar ne nenin 71 paragrafi 4 të LPP-së, sqaron: *"Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit*", andaj operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë konform nenit 69 paragrafi 8 të LPP-së, mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjerë.

Sqarimi: Nr. 6

Ndërsa sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ku thuhet: *"OE dështon të dështoi 3 kamion borëpastrues në pronësi e po ashtu dështon të dështoi Makinerinë e lehtë për pastrimin e trotuareve dhe Shesheve 1 copë",* ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues konform nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, me dt. 28 shkurt 2017, ku thuhet: *Të përcaktohet lista e pajisjeve për realizimin e punëve në këtë lot.*

Konzorciumi i OE i rekomanduar për kontratë konform kërkesës së autoriteti kontraktues me dt. 28 shkurt 2017, dorëzon në autoriteti kontraktues Listën e pajisjeve ne posedim të kompanisë "Dorearti" (origjinal) dhe listën e pajisjeve "Granit" sh.p.k. (origjinal) bashkangjitur librezat e regjistrimit, duke e specifikuar: *pajisjet 1-3 do të përdoren për Lot 1, që e plotësoj Liderin e konzorciumit për* ***"Mirëmbajtja e rrugëve në qytet Lot 1"****, kurse makineria tjetër mund të përdoret eventualisht për plotësimin e kushtit për konkurrim në Lot 2.*

Sqarimi: Nr. 7

Bazuar ne sqarimet lartë përmendura, ekspertja shqyrtues propozoj që lënda të kthehet në rivlerësim , duke i mundësuar operatorit ekonomik ankues qasje ne dokumente të ofertuesve dhe në raport të komisionit vlerësuar ashtu siç parashihet në nenin 10 të LPP-së.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Bazuar ne sqarimet e cekura në raport, eksperti shqyrtues mendon se autoriteti kontraktues Komuna e Pejës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës" Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/221, nuk i ka respektuar në tersi dipsozitata e LPP-së.

Andaj, eksperti shqyrtues duke pasur parasysh konstatimin nr. 3 dhe nr. 7, i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues ta aprovoj si pjesërisht të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin- njoftimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues dhe lëndën ta kthej në Rivlerësim.